



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Drejtuar: Operatorit ekonomik “BE-IS” shpk

Adresa: Lagjia Nr.1, Pall Metalurgu, Hyrja 1, Kukës.

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Ndërtimi i rrugëve ”Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza II”

Numri i referencës së procedurës: REF-81993-08-03-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Ndërtimi i rrugëve ”Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza II”

Fondi limit: 39,839,629.48 (tridhjetë e nëntë milion e tetëqind e tridhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë pikë dyzet e tetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 8 (tetë) muaj kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 20.09.2018, ora 11:00.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 32 datë 13.08.2018.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Alesio 2014” shpk

NUIS L41713003M

Vlera e ofertës = 27,111,821.20 (njëzet e shtatë million e njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e një pike njëzet) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “B-93” sh.p.k

NUIS J62903508R

Vlera e ofertës =
30,348,459 (tridhjetë milion e treqind e dyzet e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë e

nëntë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Ergi” shpk

NUIS K02727229P

Vlera e ofertës = 31,257,977 (tridhjetë e një milion e dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik “BE-IS” shpk

NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = 32,594,589 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

5. Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk

NUIS K51712017A

Vlera e ofertës = 33,066,131.20 (tridhjetë e tre milion e gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e tridhjetë e një pikë njëzet) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Senka” shpk

NUIS J94808405Q

Vlera e ofertës = 33,114,663 (tridhjetë e tre milion e njëqind e katërmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

7. Operatori ekonomik “Bajrami N” shpk

NUIS K02727202O

Vlera e ofertës = 33,741,641.25 (tridhjetë e tre milion e shtatëqind e dyzet e njëmijë e gjashtëqind e dyzet e një pikë njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk

NUIS K02003001O

Vlera e ofertës = 0 (zero) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Alesio 2014” shpk
NUIS L41713003M**

- Shoqëria “Alesio-2014” shpk për të vërtetuar përvojën e suksesshme ka paraqitur kontratat me objekt: “Rikonstruksion i plotë + sistemim i ngrohjes për dy godinat e shkollës 9-vjeçare “Pjetër Arbënor”, Fushë Arrëz” dhe “Kapanon 2-3 kat për prodhim tenda dielli”. Këto kontrata nuk janë punime të ngjashme për faktin se këto kontrata hyjnë në kategorinë e punëve të infrastrukturës së objekteve dhe jo të infrastrukturës rrugore referuar situacioneve përfundimtare të punimeve ku zërat e punimeve të përcaktuar në bazë të preventivit nuk janë të ngjashme me zërat e preventivit të objektit që prokurohet. Më tej shoqëria “Alesio-2014” shpk ka paraqitur edhe disa kontrata të tjera të ngjashme me objektin e prokurimit si më poshtë vijon:

- 1- Kontratë nënsipërmarrje me objekt: “Asfaltim rruga Pistull – Pacran – Rrugë nacionale” me vlerë të kontratës 18,124,268 lekë pa TVSH;

- 2- Kontratë nënsipërmarrje me objekt: “Sistemim i lagjes mbrapa Pallatit të Kulturës” me vlerë të kontratës 2,062,832 lekë pa TVSH;
 - 3- Kontratë nënsipërmarrje me objekt: “Rikonstruksion i rrugës “25- Nëntori”, Elbasan” me vlerë të kontratës 19,482,749 lekë pa TVSH;
 - 4- Kontratë nënsipërmarrje me objekt: “Riveshje asfalti në rrugën “Elbasan, Tregan” me vlerë të kontratës 7,047,160 lekë pa TVSH.
- Sa më sipër konkludohet se Operatori ekonomik “Alesio-2014” shpk në lidhje me kontratat e mësipërme të paraqitura për të vërtetuar përvojën e sukseshme nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1/a për një objekt të vetëm në vlerën **19,919,814.74** lekë pa TVSH si edhe pikën 1/b ku shumatorja e të gjitha kontratave të ngjashme duhet të jetë në vlerën **79,679,258.96** lekë pa TVSH.
 - Në këtë mënyrë, shoqëria “Alesio-2014” shpk nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1 çka bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) Neni 46, pika 1 gërma “b” si dhe me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 6.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “B-93” shpk NUIS J62903508R

- Operatori ekonomik ka paraqitur një deklaratë për stafin inxhinierik pa deklaruar Drejtuesin Teknik a përcaktuar Drejtuesin Teknik çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, pika 3, Kapaciteti Teknik: *“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme....”*.
- Operatori ekonomik “B 93” nuk përmbush pikën 16 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”* pas për mjetin eskavator me goma marrë më qera me anë të kontratës Rep.4304, KOI.1841 nuk është paraqitur dokumentacioni i kërkuar sipas gërmës “a” : *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e*

ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes”.

- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “B-93” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Ergi” shpk NUIS K02727229P

- Operatori ekonomik “Ergi” shpk nuk ka paraqitur *“Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Korrik 2017 - Korrik 2018, çka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 4, germa a).*
- Operatori ekonomik “Ergi” shpk nuk plotëson pikën 16 të kapaciteti teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 9)...”* Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 10 ton”, pasi për Automjetin me targa AA367 HC nuk është asnjë dokumentacion tekniko-ligjore, ndërsa Automjeti me targa AA956LV leja e qarkullimit të mjetit nuk është paraqitur e plotë, çka bën të pamundur llogaritjen e kapacitetit mbajtës, çka bie në kundërshtim edhe me dokumentat standarte të tenderit *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhën e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit ose faturat tatimore te blerjes” ; “Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- Operatori ekonomik “Ergi” shpk nuk plotëson pikën 16 të Dokumentave Standarte të Tenderit, tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit , Kapaciteti Teknik *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10)”*, pasi nuk ka deklaruar në shtojcën 10, mjetin, Makineri vijëzimi me bojë bikomponente, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit , Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik , pika 16.
- KVO, pasi verifikoi Shtojcën 10 konstatoi se mjeti Autobot uji me targë EL0128C rezulton të jetë i montuar = Kamion + depozitë uji, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16 ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë 1 (një) Autobot uji”.*

- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Eskavator me goma”, të deklaruar në Shtojcën Nr. 10, u konstatua se është paraqitur vetëm me faturë tatimore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, germa a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk NUIS K51712017A

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin e stafit teknik, konstatoi se Inxhinieri i Ndërtimit i deklaruar nga Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk është i profilit transport, çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Gjithashtu KVO konstatoi se diploma e Inxhinierit Topograf të paraqitur nga shoqëria “Kacdedja” shpk është fotokopje, çka bie në kundërshtim me DST ku përcaktohet se: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”.*
- Referuar Shtojcës 10, Shoqëria “Kacdedja” shpk ka deklaruar se disponon 1 (një) Eskavator me goma me targa ACMT22. KVO, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetin e sipërcituar, konstatoi se mjeti disponohet nëpërmjet Kontratës së Huapërdorimit me Nr. 11371/1 Rep. Nr. 7064/I Kol. datë 01.10.2016 për një afat 2-vjeçar (deri më 01.10.2018). Për sa më lart, Operatori ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, germa “a” ku përcaktohet se: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) certifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.” (Sjellim në vëmendje se afati kohor i përcaktuar në DST për realizimin e objektit është 8 (tetë) muaj kalendarikë.)*

- Gjithashtu Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 1 (një) Autobot uji me targa AA 973 OM për të cilin nuk ka paraqitur foto, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 15, gërma “e”.
- Referuar Faturës së Thjeshtë Tatimore Nr. 36 datë 07.10.2011, rezulton se Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk disponon 3 (tre) copë fikëse zjarri, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, ku ndër të tjera përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të disponojë Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 (pesë) copë”*.

5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Senka” shpk NUIS J94808405Q

- KVO konstaton se Leja e Qarkullimit për mjetin Kamion me kapacitet mbajtes me targë AA 718 RO, të marrë me qera rezulton fotokopje e pashoqëruar me vërtetimin e njëhësimin të kopjes me origjinalin cka bie në kundërshtim me kushtin e përcaktuar në DST: *“Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”*.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për mjetet e deklaruar nga operatori ekonomik “Senka” shpk, konstatoi se për mjetet “Kamion” me targa AA334 FL, AA 628 KR, si dhe AA718 RO nuk janë paraqitur foto, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, gërma “e”.

6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Bajrami N”shpk NUIS K02727202O

- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Eskavator me goma”, të deklaruar në Shtojcen Nr.10, u konstatua se janë paraqitur vetëm me faturë tatimore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues për mjetin “Autobitumatrice”, të deklaruar në Shtojcen Nr.10, u konstatua se janë paraqitur vetëm me faturë tatimore dhe jo dokumentacioni i plotë tekniko-ligjor, çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret

e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 16, germa a), ku përcaktohet se: “Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerash/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore të blerjes.

- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Bajrami-N” shpk, referuar Shtojcës 10 si edhe dokumentacionit shoqërues për mjetet e paraqitura, nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

7. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk NUIS K020030010.

- Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi që skedari i ngarkuar në S.P.E, me emërtimin “Shtojca 1- Preventiva-grafike-shtojca 5”, i shoqërisë “Eurondertimi 2000” shpk, në të cilën përfshihet dhe “Formulari i Ofertës” është i paaksesueshëm.
- Nisur nga ky fakt, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nëpërmjet shkresës Nr.34623Prot. datë 20.09.2018, ka kërkuar asistencë teknike nga Agjensia e Prokurimit Publik dekriftimin e Ofertës Ekonomike. A.P.P nëpërmjet shkresës me Nr. 8713/1 Prot. datë 27.09.2018, hyrë në Bashkinë e Tiranës me Nr. 34623/1Prot. datë 01.10.2018, ka bërë të mundur procesin e dekriftimit.
- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstatuan se informacioni në skedarin e më sipërm, edhe pas ndërhyrjes së APP-se, është sërish i palexueshëm. Ju bëjmë me dije se ngarkimi dhe ruajtja e dokumentave në sistem duhet të realizohet sipas udhëzimeve të A.P.P-së.
- Për sa më lart, është përgjegjësi e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës, pasi nuk e ka realizuar në mënyrë të plotë këtë proces.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “BE-IS” shpk**, me adresë: **Lagjia Nr.1, Pall Metalurgu, Hyrja 1, Kukës**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **32,594,589 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë** pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 05.10.2018

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(e ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk u paraqit asnjë ankesë.

